



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

**Prokurori i Specializuar kundër Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit
dhe Haxhi Shalës**

Vendosi: Gjykatësja e Procedurës Paraprake

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 20 qershor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Januzit për Zgjatje të Afatit

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit

Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit

Felisiti Geri

Mbrojtjes së Haxhi Shalës

Tobi Kadman

Xhon Kabën

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(1) dhe (13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 9(5)(a) dhe 76 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 27 mars 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin që Përcakton Kalendarin për Hapat e Mbetur Proceduralë të Fazës së Procedurës Paraprake” (“Vendimi mbi Kalendarin e Procedurës Paraprake”) , ndër të tjera, duke urdhëruar Mbrojtjen e Sabit Januzit (“z. Januzi” dhe “Mbrojtja e Januzit”), Mbrojtjen e Ismet Bahtijarit (“z. Bahtijari dhe “Mbrojtja e Bahtijarit”) dhe Mbrojtjen e Haxhi Shalës (“Mbrojtja e Shalës”) (së bashku “Ekipet e Mbrojtjes” ose “të akuzuarit”) që të parashtrojnë dosje paraprake, nëse kanë, jo më vonë se të premten, 7 qershor 2024.²

2. Më 5 qershor 2024, në bazë të kërkesës së Mbrojtjes së Bahtijarit,³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake zgjati afatin e caktuar për dorëzimin e dosjes paraprake deri më 20 qershor 2024 për të gjitha ekipet e Mbrojtjes (“Vendimi i Parë për Zgjatje të Afatit”).⁴

3. Më 17 qershor 2024, Mbrojtja e Januzit paraqiti kërkesë për zgjatje tjetër të afatit të caktuar më parë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake për dorëzimin e dosjes paraprake. (“Kërkesa”).⁵

¹ KSC-BC-2023-10, F00327, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatëses së Procedurës Paraprake*, 6 qershor 2024, publik.

² KSC-BC-2023-10, F00233, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim që Përcakton Kalendarin për Hapat e Mbetur Proceduralë të Fazës së Procedurës Paraprake*, 27 mars 2024, publik, para. 27, 30(i).

³ KSC-BC-2023-10, F00310, Mbrojtja e z. Bahtijari, *Parashtrimi i Bahtijarit për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Dosjes Paraprake*, 31 maj 2024, publik.

⁴ KSC-BC-2023-10, F00324, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Bahtijarit për Zgjatje të Afatit*, 5 qershor 2024, publik.

⁵ KSC-BC-2023-10, F00340, Mbrojtja e z. Januzi, *Parashtrimi i Januzit për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Dosjes Paraprake*, 17 qershor 2024, publik.

4. Më 18 qershor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") bëri me dije se nuk ka ndër mend t'i përgjigjet kërkesës.⁶
5. Më 19 qershor 2024, Mbrojtja e Shalës iu përgjigj kërkesës ("Përgjigjja e Shalës").⁷
6. Më të njëjtën ditë, Mbrojtja e Bahtijarit bëri me dije se nuk ka ndër mend t'i përgjigjet kërkesës.⁸
7. Gjithashtu, më të njëjtën ditë, Mbrojtja e Bahtijarit dorëzoi dosjen e vet paraprake në bazë të rregullës 95(5) të Rregullores.⁹

II. PARASHTRIMET

8. Mbrojtja e Januzit parashtron se rrethanat që mbështesin konstatimin e arsyeve të vlefshme në Vendimin e Parë për Zgjatje të Afatit nuk kanë ndryshuar, pasi është konstatuar se është vërtetuar dyshimi i bazuar në lidhje me ndryshimet e aktakuzës kundër z. Januzi dhe z. Bahtijari, ("Aktakuza") të kërkuara nga ZPS-ja ("Vendimi mbi Kërkesën e ZPS-së për Ndryshime").¹⁰ Mbrojtja e Januzit parashtron mbi këtë bazë se ekzistojnë arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit dhe kërkon zgjatje të afatit për dorëzimin e dosjes së vet paraprake, deri në shtatë (7) ditë pas njoftimit të Vendimit mbi Kërkesën e ZPS-së për Ndryshime.¹¹

⁶ KSC-BC-2023-10, CRSPD59, Mesazh elektronik nga ZPS-ja drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake në Lidhje me Përgjigjen ndaj F00340, 18 qershor 2024, në orën 12:13, konfidencial. Shih gjithashtu, CRSPD59, Mesazh elektronik nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake drejtuar Palëve në lidhje me Përgjigjen ndaj F00340, 18 qershor 2024, në orën 11:13, konfidencial.

⁷ KSC-BC-2023-10, F00342, Mbrojtja e z. Shala, Përgjigje ndaj Parashtrimit të Januzit për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Dosjes Paraprake, 19 qershor 2024, publik. Shih gjithashtu CRSPD59, Mesazh elektronik nga Mbrojtja e Shalës në Lidhje me Përgjigjen ndaj F00340, 18 qershor 2024, në orën 15:47, konfidencial.

⁸ KSC-BC-2023-10, CRSPD59, Mesazh elektronik nga Mbrojtja e Bahtijarit drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake në Lidhje me Përgjigjen ndaj F00340, 19 qershor 2024, në orën 11:04, konfidencial.

⁹ KSC-BC-2023-10, F00343, Mbrojtja e z. Bahtijari, Dosja Paraprake e Bahtijarit, 19 qershor 2024, konfidenciale.

¹⁰ Kërkesa, para. 2, 4-6.

¹¹ Kërkesa, para. 6-7.

9. Mbrojtja e Shalës nuk e kundërshton kërkesën por përsërit shqetësimin që çështja të vijojë sa më shpejt, duke pasur parasysh se të akuzuarit janë në paraburgim.¹²

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Në pajtim me nenin 39(1) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencë që të lëshojë çdo urdhër apo vendim të nevojshëm për të siguruar që çështja të përgatitet siç duhet dhe në mënyrë të shpejtë për gjykim.

11. Në pajtim me nenin 39(13) të Ligjit dhe rregullës 95(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake siguron që procedura paraprake të mos ketë vonesa të papërligjura dhe merr të gjitha masat e nevojshme për përgatitjen e shpejtë të çështjes për gjykim.

12. Në bazë të rregullës 9(5)(a) të Rregullores, në qoftë se i tregohen arsye të vlefshme ose *proprio motu*, Paneli mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara në Rregullore apo prej Panelit.

13. Në bazë të rregullës 76 të Rregullores, kërkesat për zgjatje të afatit paraqiten në kohë për t'i lënë Panelit kohë të mjaftueshme për marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën para përfundimit të afatit përkatës.

14. Në bazë të rregullës 95(5) të Rregullores, pas dorëzimit të materialeve të përmendura në rregullën 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake fton Mbrojtjen që brenda një afati të përcaktuar të dorëzojë dosjen e vet paraprake.

15. Në pajtim me rregullën 95(2)(j) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake cakton një datë të synuar kur çështja duhet të jetë gati për gjykim.

¹² Përgjigjja e Shalës, para. 12-14.

IV. DISKUTIM

16. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kërkesa është dorëzuar mjaftueshmërisht në kohë, në përputhje me rregullën 76 të Rregullores.

17. Sa u përket arsyeve të vlefshme, duke pasur parasysh nevojën për të siguruar që lënda të përgatitet sa më shpejt për gjykim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr gjithashtu parasysh faktin se: (i) z. Januzi ka ndër mend të dorëzojë dosjen e vet paraprake; (ii) ende nuk është konstatuar nëse është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë në lidhje me ndryshimet e aktakuzës kundër z. Bahtijari dhe z. Januzi të kërkuara nga ZPS-ja në bazë të rregullës 86(4);¹³ dhe (iii) z. Januzi gjykon se, me qëllim që ai të jetë në gjendje në dosjen e vet paraprake t'i përgjigjet akuzave, është e domosdoshme të zgjidhen aspekte që kanë të bëjnë me Aktakuzën. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh faktin se Mbrojtja e Shalës, Mbrojtja e Bahtijarit, dhe ZPS-ja, nuk e kundërshtojnë Kërkesën.¹⁴

18. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, në rrethanat aktuale, janë paraqitur arsye të vlefshme që përligjin zgjatjen e afatit kohor. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron të përshtatshme zgjatjen e afatit për dorëzimin e dosjes paraprake, nëse kanë, për të gjitha ekipet e Mbrojtjes, deri në shtatë (7) ditë pas njoftimit të vendimit mbi kërkesën e ZPS-së për ndryshime. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, nëse dëshiron, Mbrojtja e Bahtijarit mund të dorëzojë dosjen e vet paraprake të përditësuar brenda afatit të lartpërmendur.

19. Gjithashtu, bazuar në sa më lart dhe duke pasur parasysh natyrën thelbësore të kësaj pike të hapur, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos të shtyjë datën e kalimit

¹³ Shih KSC-BC-2023-10, KSC-BC-2023-10, F00189, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)*, 27 shkurt 2024, konfidenciale, me Shtojcat 1-2, konfidenciale; F00294, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Aktakuzës*, 17 maj 2024, konfidencial, para. 45-46.

¹⁴ Shih më lart para 4, 6, 9.

të dosjes gjyqësore trupit gjykues, që ishte caktuar të jetë 5 korrik 2024.¹⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, në rrethanat aktuale, shtyrja e afatit deri në nxjerrjen e Vendimit mbi Kërkesën e ZPS-së për Ndryshime është e domosdoshme dhe në përputhje me këtë cakton datën e re paraprake për kalimin e dosjes gjyqësore trupit gjykues për katërmëdhjetë (14) ditë pas njoftimit të Vendimit mbi Kërkesën e ZPS-së për Ndryshime.

V. VENDIM

20. Për arsyet e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **MIRATON** Kërkesën;
- b) **URDHËRON** ekipet e Mbrojtjes të dorëzojnë dosjet e tyre paraprake, nëse kanë, brenda shtatë (7) ditëve nga njoftimi i Vendimit mbi Kërkesën e ZPS-së për Ndryshime; dhe
- c) **CAKTON** datën e re paraprake për kalimin e dosjes gjyqësore Trupit Gjykues për katërmëdhjetë (14) ditë pas Vendimit mbi Kërkesën e ZPS-së për Ndryshime.

_____/nënshkrimi/____

Gjykatëse Marzhor Masëlo
Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E enjte, 20 qershor 2024
Në Hagë, Holandë.

¹⁵ Shih Vendimin e Parë për Zgjatjen e Afatit, para. 19, 20(c).